



**INSTITUCIONET E PËRKOHSHME TË VETËQEVERISJES
PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF-GOVERNMENT
PRIVREMENE INSTITUCIJE SAMOUPRAVLANJA**

QEVERIA E KOSOVËS - GOVERNMENT OF KOSOVO - VLADA KOSOVA

**MINISTRIA E PUNËS DHE MIRËQENIES SOCIALE
MINISTRY OF LABOUR AND SOCIAL WELFARE
MINISTARSTVO RADA I SOCIJALNE ZAŠTITE**

Në përputhje me nenin 1.3 pika (ç) të Rregullores së UNMIK-ut 2001/19 mbi Degën e Ekzekutivit të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë,

Duke pasur parasysh shtojcën VII pika (xiii) të Rregullores 2001/19,
Me qëllim të sigurimit të beneficioneve më favorizuese financiare për punëtorët e Kompleksit “TREPÇA”, Ministri i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale nxjerr këtë:

PROPOZIM Nr. 10/2005

PËR

**NDRYSHIMET DHE PLOTËSIMET E UDHËZIMIT ADMINISTRATIV NR. 03/2003
PËR PENSIONIM TË PARAKOHSHËM PËR PUNËTORËT E KOMPLEKSIT
“TREPÇA” NËN ADMINISTRIMIN E UNMIKU-ut**

Neni 1

**Teksti i nenit 3 në paragrafët 1,2 dhe 3 i Udhëzimit Administrativ nr. 03/2003
ndryshohet dhe plotësohet me këtë përmbajtje:**

- 1.1** Lartësia e shumës së pensionit të parakohshëm për punëtorët e vlerësuar nga Komisioni Mjekësor si të paaftë për punë në minierë me mihje nëntokësore do të jetë **80,00€ (euro)**, ndërsa për punëtorët e tjerë të cilët i plotësojnë kushtet dhe kriteret sipas Udhëzimit Administrativ nr. 03/2003 do të rritet nga **40,00€ në 50,00€** dhe atë duke filluar nga **01.07.2005**.
- 1.2** Pagesat e pensionit të parakohshëm për punëtorët e “TREPÇES” në këto shuma, do të bëhen deri në nxjerrjen e ndonjë akti ligjor për pensionet e parakohshme, të cilat do të administrohen nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale në bashkëpunim me menaxhmentin e “TREPÇES” nën administrimin e UNMIK-ut.

1.3 Menaxhmenti i “TREPÇES” nën administrimin e UNMIK-ut dhe minierave me mihje nëntokësore, do të jetë përgjegjës për përzgjedhjen e punëtorëve si shfrytëzues potencial të pensioneve të parakohshme sipas kushteve dhe kriterëve të përcaktuara në Udhëzimin Administrativ 03/2003, ndërsa administrimin e pagesave do ta bëjë Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale përmes Departamentit të autorizuar të Administratës Pensionale të Kosovës.

Neni 2

Teksti i nenit 4 në paragrafët 1,2, dhe 3 të Udhëzimit Administrativ nr. 03/2003 do të ndryshohet dhe plotësohet me këtë përmbajtje:

2.1 Qeveria e Kosovës përkatësisht Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale nga mjetet buxhetore do të bëjë pagesën e pensioneve të parakohshme, duke bërë transferim mujor të parave në bankat komerciale të Kosovës të licencuara nga autoriteti bankar i pagesave të Kosovës në llogaritë personale të përfituesve të pensionit të parakohshëm në përputhje me rregullat e përcaktuara në Memorandumin e Mirëkuptimit të lidhur në mes të MPMS-së dhe Menaxhmentit “TREPÇA” nën administrimin e UNMIK-ut në tetor të vitit 2003.

2.2 Para transferimit të parave nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës në bankat komerciale, menaxhmenti i “TREPÇES” duhet të përgatisë regjistrin e shfrytëzuesve të cilët kanë përfituar për të qenë shfrytëzues të pensionit të parakohshëm me të dhënat identifikuese, duke përfshirë: emrin, mbiemrin, datëlindjen, adresën dhe numrin e letërnjoftimit të UNMIK-ut.

2.3 Në regjistrin e personave të përzgjedhur si shfrytëzues të pensionit të parakohshëm, gjatë kohëzgjatjes së këtij programi, nuk mund të jetë asnjë person që nuk i plotëson kushtet dhe kriteret e parapara në Udhëzimin Administrativ nr. 03/2003. Në rast se numri aktual i shfrytëzuesve të pensionit të parakohshëm është më i vogël se numri i prezentuar në regjistrin origjinal, mjetet e mbetura të transferuara do të rikthehen nga bankat komerciale në MPMS në përputhje me rregullat e përcaktuara në Memorandumin e Mirëkuptimit.

Neni 3

3.1 Ky propozim për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativ nr. 03/2003 hynë në fuqi pas nënshkrimit nga Ministri i MPMS-së, ndërsa do të aplikohet në mënyrë retroaktive nga 01.07.2005.

**Ministri i MPMS-së
Ibrahim Selmanaj**

Prishtinë, korrik 2005

Ndërtesa e re e Fakultetit Ekonomik
Prishtinë,

New building of economic faculty
Prishtina
Tel. 038/244 228, Fax.038/244 229

Zgrada novog ekonomskog fakulteta
Priština